



QENDRA
KOMBËTARE E
KINEMATOGRAFISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot: 168/1
Tiranë, Dt. 19 Nëntor 2024

KRYETARI

URDHËR

Nr. 66

Datë 18/11 /2024

“Për një ndryshim në“ Rregulloren e Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve Nr.168 Prot. Datë 27.05.2024”

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” (i ndryshuar); të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.602, datë 21.08.2003, “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” (i ndryshuar),

URDHËROJ

Pika 5 e gërmës D e Kreut V, Marrëdhëniet e QKK me Producentët/Shtëpitë Kinematografike dhe Distributorët, nën IV, Rregulla të Përgjithshme për Aplikim, të ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Afati i aplikimit për konkurset për film artistik me metrazh të gjatë dhe film artistik vepër e parë dhe e dytë të jetë të paktën një muaj nga data e shpalljes. Për të gjitha projektet e tjera kinematografike ky afat mund të jetë më i shkurtër.

Pika 8 nën VII Nënshkrimi i Kontratës, e Kreut V, Marrëdhëniet e QKK me Producentët/Shtëpitë Kinematografike dhe Distributorët të ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Për projektet e kategorisë Koproduksion në Pakicë (Minority Coproduction) financimi fillestar do të jetë jo më shumë se 80% e fondit të akorduar nga QKK.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Eol ÇASHKU

